

REPUBLICA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNAL NË MALISHEVË

Kryesuesi i Kuvendit

Nr. 01/

Dt.31.05.2024

Nga : Kuvendi i Komunës së Malishevës,
Kryesuesi- Argjend Thaçi

Për : Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar,
“ Paçarizi HP Grup“ sh.p.k
Menaxherit drejtues z.Shpend Paçarizi.

Kopje: Arkivit të komunës

Datë: 31/05/2024

Lënda: **P Ë L Q I M**

I jepet pëlqimi kompanisë “ PAÇARIZI HP GRUP “ sh.p.k, me seli në fshatin Dragobil, me menaxher drejtues z. [redacted], i lindur me datë, 18.07.1992, me numër të letërnjoftimit të lëshuar nga MPB- [redacted] RKS, me vendbanim në fshatin Dragobil KK- Malishevës, për rregullimin e dokumentacionit të mëtutjeshëm me rastin e ushtrimit të veprimtarisë, sipas Çertifikatës së Regjistrimit të Biznesit me numër unik identifikues [redacted]

Ushtrimi i veprimtarisë së lartcekur, sipas parashtresës nr.02/203, dt.17.05.2024, jepet për vendosjen e bazës së betonit për nevojat e subjektit në fjalë, në fshatin Dragobil, në pjesën e njësise P-72310025-00474-1, në vendin e quajtur Golesh, në sipërfaqe prej 17780 m² me kulturë tokë pyjore, mal i klasit 4, në emër të z. [redacted], nga fshati Dragobil, KK- Malishevës, e dhënë me qira z. [redacted], sipas Kontratës së datës 16.05.2024.

Ky dokument nuk mund të përdorët për qëllime të vërtetimit apo mohimit të drejtave të palëve në çfarëdo procedure ligjore, por shërben vetëm për të dhënë pëlqimin se një veprimtari e tillë nuk e pengon komunën e Malishevës.

Udhëzohet kompania në fjalë që të kryej të gjitha procedurat tjera ligjore në organet tjera kompetente, për të ushtruar veprimtarinë për të cilin merret ky pëlqim.

Me respekt,